



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 858/1 Prot

Tiranë, më 14.04.2025

V E N D I M

Nr.28, datë 14.04.2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE DHE QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA E SHKOLLIMIT ME 100% NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, PËR VITIN AKADEMIK 2024– 2025, (raste të veçanta, faza e tretë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", ndryshuar me VKM nr.784, datë 26.12.2018 dhe VKM nr. 39, datë 23.01.2019, Memon e Drejtorisë Juridike Nr. 311/5 prot., datë 11.04.2025, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 858 Prot., datë 04.03.2025 në mbledhjen e tij të datës 14.04.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve që përfitojnë bursë financiare dhe që përjashtohen nga tarifa e shkollimit me 100 % në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, për vitin akademik 2024-2025.
 2. Efektet financiare për 1 (një) student që përfitojnë bursë dhe 2 (dy) që përjashtohen 100% nga tarifa e studimit janë në total 179,000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, përkatësisht:
 - a.) Bursat, në vlerën 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.
 - b.) Përjashtimi 100% nga tarifa e studimit në vlerën 89,000 (tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI Kryetar

Sokol DURO Anëtar

Florian NURCE Anëtar

Donika KËRÇINI Anëtar

Blerina DUKA Anëtar

Albert KOPALI Anëtar

Altin PRENGA Anëtar

Konceptoi: N. Ndoci